

Luan TETAJ

PIKËPAMJET ILUMINISTE DHE SHQIPTARËT GJATË RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Iluminizëm “Lumières” është emri që i vunë në Francë fenomenit evropian, “Enlightenment” në Angli dhe “Aufklärung” në Gjermani etj. Me emrin iluminizëm identifikohen intelektualët francezë që i dhanë vend të rëndësishëm arsyes, vullnetit por edhe imagjinatës për të njohur botën dhe për të rindërtuar shoqërinë. Për iluministët e keqja vinte nga kisha e cila ishte burim i obskurantizmit që patjetër duhej kundërshtuar. Shekulli XVIII është quajtur «shekulli i filozofëve».¹ Fryma iluministe u ndikua edhe në vendet e tjera të Evropës dhe më gjerë. Me zhvillimin e ekonomisë, kulturës, politikës etj., pikëpamjet iluministe arritën nivelin më të lartë të saj. Iluministët gjatë shekullit XVIII e kundërshtonin politikëbërjen e asaj kohe, sepse për qëllim kishin lirinë e të menduarit nga ideologjitë fetare dhe orientimet drejt zhvillimeve dhe botëkuptimeve të reja.² Karakteristikë e shekullit të iluminizmit ishte shkëmbimi i ideve, kritikave, polemikave, komunikimit publik etj.

Dalamberi, shok i Didëros dhe autor i “Discours préliminaire à l’Encyclopédie” (Fjalimi paraprak në enciklopedi), shprehet për kohën e tij, sipas të cilit Racionalizmi i shek. XVIII ishte qëndrim dhe proces që shtrihej në hapësirë dhe në kohë.³ Shoqëria para periudhës së iluminizmit pothuajse pjesa më e madhe e saj ishte e ndikuar nga ideologjitë fetare. Iluministët nuk e predikonin iluminizmin, por elementin e fesë me tolerancë natyrore. Pikëpamjet iluministe nuk e kishin në platformë të

¹ Gilbert Hattois, *La Philosophie Française au "Siècle des Lumières"*, Paris, 1997, f. 112.

² Masar Stavileci, Iluminizmi shqiptar, “Botime Toena”, 2000, f. 8

³ Gilbert Hattois, *La Philosophie Française au...*, f. 114.

hidhnin poshtë fenë, por ishin ithtarë të mëdhenj të tolerancës dhe lirisë fetare të secilit individ. Pikëpamjet iluministe favorizonin arsimit pa marrë parasysh format e tij të zhvillimit, që nga institucionet me të larta shkencore e deri të transmetimi i diturive nëpërmjet botimeve etj.⁴ Për një periudhë të gjatë frymën iluministe e kultivuan një grup dijetarësh që krijuan një realitet të ri në të gjitha elementet e jetës. Me kalimin e kohës pikëpamjet e tyre iluministe e shtrin ndikimin e tyre edhe te shtresat e gjera të shoqërisë.

Ishte shumë e vështirë apo e pamundur që fryma iluministe të zhvillohej brenda një vendi të caktuar. Secili vend dha kontribut të çmuar që të përqafojnë dhe të integrohen në pikëpamjet e reja iluministe, varësisht nga zhvillimet e tyre ekonomike, kulturore, politike etj. Pikëpamjet iluministe si parim bazë kishin forcimin e arsyes, zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës etj.⁵ Vetëm atëherë do të ndryshojë qasja duke përqaftuar idetë iluministe, njeriu mund të mendojë dhe veprojë lirshëm për emancipimin e përgjithshëm dhe ndryshimin e gjendjes që ishte deri në atë periudhë.

Shumë filozofë ishin deistë, të cilët besojnë në një Zot të vetëm dhe universal, por jo të definuar në mënyrë të njëjtë dhe të kënaqshme për të gjithë. Çdo njeri krijon një formë të Zotit me një imazh pak a shumë preciz, gjithmonë sipas përvojës personale fetare. Disa e ndiejnë Zotin thellë në zemër ose në vetëdijen e tyre, të tjerët mendojnë në ekzistencën e nevojshme kur e kërkon arsyeja. Disa e zbulojnë në përvojën e tyre të brendshme, të tjerët e shohin në veprat e natyrës etj. Volteri dhe Rusoja ishin deistë, por shumë të ndryshëm. Zoti i Volterit është një dituri e arsyeshme racionaliste që garanton rendin kozmik. Ai është orëtar i orës së botës, ndërsa Zoti i Rusos është brenda në njeriun, i dashur dhe i vetëdijshëm. Ajo që i bashkon iluministët është toleranca.⁶ Nuk ishte fare e lehtë që pikëpamjet iluministe të përhapeshin në frymën e dëshiruar, ku si forcë e arsyes idetë iluministe u përhapen në një formë edhe revolucionare, sepse në shumë vende akoma rendi feudal ishte i fortë. Franca si çerdhe e iluminizmin në Evropë, nuk e kishte fare të lehtë zhvillimin e saj politik dhe ekonomik në mënyrë që vendi t'i përshtatej një rendi dhe realiteti të ri.

⁴ Tzvetan Todorov, *Fryma e Iluminizmit*, "Buzuku", Prishtinë, 2009, f. 9.

⁵ Masar Rizvanolli, *Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Prishtinë, 1990, f. 14.

⁶ Gilbert Hattois, *La Philosophie Française...*, f. 116.

Sipas Sartrit “*imazhi i iluminizmit i bën thirrje lirisë së publikut të tij, ndërsa sa i përket Winckelman, historian e teoricien i kthimit në antikë, pohon se liria e të menduarit mund t’i zhvillojë idetë përparimtare. Çfarëdo që të jetë zgjedhja dhe format që i adaptojnë në stilin e tyre, të gjithë artistët e iluminizmit kanë ide të larta dhe dinjitet moral në misionin e tyre në shoqëri. “Liria morale” si dimension shpirtëror ose thënë më mirë njerëzor, që pa ndihmë të asnjë metafizike do t’ua mundësonte njerëzve ta tejkalonin dhunën kozmike ose historike që i shkatërron*”.⁷ Sipas Kantit iluminizmin është: “*Dalje e njeriut nga mituria, për të cilën papjekuri ai është vetë përgjegjës. Mituri do të thotë pamundësi të gjykosh, të mendosh dhe të veprosh vetë pa direktivat e dikujt tjetër. Sapere aude! Guxo të mendosh! (Ki guximin të mësosh). Ki guximin të gjykosh vetë. Kjo është motoja e iluminizmit. Përtacia dhe mungesa e guximit janë faktorët kryesorë që shpjegojnë se një numër shumë i madh njerëzish, pas pavarësisimit nga natyra, mbesin vullnetarisht nën udhëheqjen e dikujt tjetër dhe se është shumë e lehtë që dikush të vihet mbi ta. Të jemi të papjekur shpeshherë na konvenon. Shumica e njerëzve, përfshirë këtu edhe gjininë e dobët, e marrin si diçka të rrezikshme hapin drejt pjekurisë. Përveç që mendojnë se është e dhimbshme dhe e vështirë, ata mbi vete kanë edhe udhëheqës që e kryejnë shumë mirë punën rreth njerëzimit. Kështu, për secilin individ është shumë vështirë të provojë të dalë nga mituria e cila i duket pothuajse gjë e natyrshme*”.⁸

Pjesa tjetër e vendeve të Evropës dhe më gjerë si referencë për të përqafuar idetë iluministe e kishte Francën dhe Anglinë. Nga vendet e lartpërmendura shumë vende tjera kanë përfituar dhe përvetësuar shumë elemente të rëndësishme për vendet e tyre. Pikëpamjet iluministe u përhapen edhe në pjesët e Evropës Lindore dhe Juglindore. Fryma iluministe u ndikua dhe u përqafua edhe nga ideologët më të shquar shqiptarë gjatë Rilindjen Kombëtare Shqiptarë në shek. XIX. Ideologët shqiptarë u bënë ithtarë të pikëpamjeve iluministe ku dhanë kontribut të çmbushëm në hartimin dhe avancimin e programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Pikëpamjet iluministe në masë të madhe u ndikuan edhe nga zhvillimi i hovshëm i shkencave humane. Iluministët njohurit e tyre të fituara përmes shkencës u mundësuan të njihnin më mirë rregullat e

⁷ Ferrone Vincenzo, *Le Monde des Lumières*, Madrid, 1997, f. 188.

⁸ Emanuel Kanti, *Beantwortung Der Frage: Was ist Aufklärung*, Berlinische Monatschrift, 1784, f. 55.

përgjithshme të jetës në përgjithësi.⁹ Pikëpamjet iluministe ishin më se të domosdoshme dhe të mirëseardhura gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, sepse përfaqësuesit e iluminizmit shqiptar u munduan maksimalisht që përvojën dhe njohurit e tyre t'u transmetonin edhe shtresave të gjera të popullit shqiptar. Të edukuar dhe arsimuar, shqiptarët mund të përmirësonin gjendjen e vështirë të krijuar gjatë shekujve, ku vetëm të arsimuar shqiptarët mund të merrnin fatin e tyre për ndryshimet politike, kulturore dhe shoqërore.¹⁰

Iluministët insistonin fuqishëm që përmes ideve të tyre të vendosnin një rend të ri, duke u shkëputur nga ideologjitë e të kaluarës. Motoja e tyre ishte paqe, harmoni, lumturi etj. Të gjitha strukturat e vjetra shtetërore, politike dhe juridike të zëvendësohen me klasa të edukuara dhe të arsimuara. Sipas iluministëve rruga e vetëm për të shkuar përpara është arsimimi dhe emancipimi i shoqërisë, sepse liria dhe arsimimi që u ka krijuar natyra nuk mund t'u merren dhe mohohet nga asnjë regjim, qoftë ai politikë apo fetar etj.¹¹ Pikëpamjet iluministe nuk u ndalen asnjëherë për të ndryshuar qeverisjet e së kaluar, sepse ishte pengesë shumë e madhe për të ardhmen. Më punën dhe përkushtimin e tyre arritën që në masë të madhe të sensibilizonin gjithë shtresat e shoqërisë, për një të ardhme të përgjithshme për të gjitha vendet e Evropës dhe më gjerë.

Pikëpamjet iluministe kishin depërtuar thellë edhe në Rilindjen Kombëtare Shqiptare gjatë shek. XIX. Ideologët e rilindjes kombëtare u bënë ithtarë të mëdhenj të ideve iluministe franceze, angleze etj. Shqiptarët të pushtuar me shekuj nga Perandoria Osmane, u mohohej liria, arsimimi në gjuhën e tyre kombëtare dhe çdo e drejtë tjetër elementare për jetë. Përfaqësuesit më të shquar të iluminizmit shqiptar i përqaftuan fuqishëm idetë iluministe dhe punuan për arsimimin e popullit shqiptar, sepse kjo ishte rruga e vetme që përmes edukimit dhe shkollimit të çlirohen edhe politikisht nga sunduesit osmanë.

Periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare gjatë shek. XIX, me zhvillimin e saj kulturor, arsimor etj., padyshim është periudha me e pasur e trashëgimisë kombëtar shqiptare.¹² Idetë iluministe u bënë promotor të lëvizjeve çlirimtare që kërkonin çlirimin e vendit nga sunduesit osmanë.

⁹ Walter Höflechner, Gëzim Hoxha, Romeo Gurakuqi, *Hyrje në studimin e historisë*, "Phoenixshkodra", Shkodër, 2004, f. 51.

¹⁰ Masar Stavileci, *Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare...*, f. 3.

¹¹ Masar Stavileci, *Iluminizmi shqiptar...*, f. 17.

¹² Ali Dida, "Ndikimi i ideve politike e shoqërore të Iluminizmit frëng në Rilindjen Kombëtare Shqiptare", *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike nr. 25-1995*, "Instituti Albanologjik, Prishtinë", Prishtinë, 1997, f. 76.

Gjatë kësaj kohe, mendja e dijës përveç që luante rol shumë të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare por e luante edhe rolin e pushkës, sepse ishte mënyra e vetme për të luftuar çlirimin e vendit.

Zhvillimi i mendimit politik shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare u pasqyrua me zhvillimin letrar në frymën iluministe dhe patriotike që mori hov të madh në zhvillimin e arsimit laik në gjuhën kombëtare. Kjo ishte rruga e vetme që njëherë e përgjithmonë t'i jepej fund ndikimeve ideologjike të kulturave të huaja. Pikëpamjet iluministe të ideologëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare e ngritën në nivel më të lartë ndërgjegjen e popullit shqiptar duke e futur arsimimin në shërbim të lëvizjeve të armatosur për çlirimin e vendit. Një ndër ngjarjet më të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e cila si përpykje politike dhe kulturore u manifestua sidomos me poezi dhe letërsi politike ku vend të rëndësishëm zënin temat më përmbajtje patriotike. Ishte një mundësi e mirë që edhe përmes poezisë të sensibilizohet populli që përmes lëvizjeve të armatosur të luftonin çlirimin e vendit.¹³ Politikat shtypëse dhe likuiduese ndaj shqiptarëve e kishin rrezikuar seriozisht ekzistencën kombëtare gjatë shekujve të mëhershëm.

Ideologët shqiptarë me idetë e tyre politike formuan programin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, me kërkesat e tyre për çlirimin e vendit nga sundimi osman. Ishte formuar një frymë e re politike, kulturore, e cila mori përsipër që shqiptarët të tejkalojnë ndasitë fetare dhe vetëm të bashkuar mund të arrinin bashkimin dhe çlirimin e vendit.¹⁴ Ideologët më punën e tyre në një mënyrë apo tjetrën morën si model iluministët francezë të shek. XVIII, për të njohur në thelb realitetin e kohës. Në frymën e kësaj logjike e kundërshtuan fuqishëm rendin shoqëror, dogmat fetare, fanatizmin fetar etj., për të përmirësuar mirëqenien e përgjithshme të popullit.¹⁵ Rruga e vetme e shqiptarëve për të dalë nga gjendja e krijuar gjatë shekujve ishte arsimimi, edukimi, emancipimi etj. Ideologët me njohurit e tyre të fituara në qendrat më të njohura të Evropës dhe të Perandorisë Osmane rreth shkencave teknike, humane etj., u munduan që në frymën iluministe t'u shpjegonin shqiptarëve të metat dhe padrejtësitë që u bënin të tjerët. Shqiptarët kishin të drejtë në kërkesat e tyre të

¹³ Stefanaq Pollo, "Roli i popullit shqiptar në historinë e re dhe të sotme", Studime historike Nr. 1, "Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë", Tiranë, 1967.

¹⁴ Masar Stavileci, *Idetë e Iluminizmit frëng dhe fryma e tij në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, tezë e doktoratës, Prishtinë, 1984, f. 318.

¹⁵ Veli Veliu, *Ndikimet letrare frënge-shqiptare*, "Vatra", Shkup 2005, f. 101.

shkolloheshin në gjuhën amtare, por kjo gjë u mohojë nga autoritetet osmane. Nevoja e arsimimit ishte e domosdoshme, sepse vetëm të arsimuar shqiptarët mund të arrinin të forcohen si popull për të luftuar të drejtat e tyre. Një ndër elementët që e frenuan arsimimin e shqiptarëve ishin edhe ndasitë fetare, sepse të huajt e përdorën elementin fetar për t'i përçarë dhe sunduar. Ideologët shqiptarë duke e ditur gjendjen e përgjithshme fetare në vend që ishte pengesë e madhe për bashkimin e shqiptarëve, ata dërguan mesazhe të forta gjithë shqiptarëve, që feja të jetë faktor i dorës së dytë.¹⁶ Në njëfarë mënyre, ideologët ia arritën qëllimit në ngritjen e vetëdijes fetare. Të huajt e përdorën këtë element për t'i asimiluar qoftë në identitetin kombëtar apo fetar. Pikëpamjet iluministe shqiptare në krahasim me idetë iluministe të vendeve evropiane, si qëllim themelor kishin çlirimin dhe bashkimin kombëtar të vendit. Përveç përkushtimit në përhapjen dhe zhvillimin e arsimit, ideologët shqiptarë e ngritën shumë edhe ndjenjën kombëtare dhe patriotike.

Një element shumë i rëndësishëm që dha kontribut të madh në përhapjen e ideve iluministe të rilindësve shqiptarë padyshim ishte edhe shtypi shqiptar. Paralelisht me lëvizjet e armatosura, shtypi u bë faktor shumë i rëndësishëm në sensibilizimin dhe rritjen e lëvizjes çlirimtare. Në ballinat e shtypit u publikuan programe me politika rreth çështjes kombëtare për çlirimin e vendit nga pushtuesit osmanë.¹⁷ Paralelisht me programin dhe zhvillimin e lëvizjes kombëtare, organet e shtypit shqiptar vijnë duke u shumuar. Ndër organet më të shquara të kësaj kohe janë, “Shqipëria e Bukureshtit”, 1879-1899; “Drita”, Sofje 1901-1908; “Shpresa e Shqypnis”, Raguzë, Romë 1905-1907; “Kombi”, Boston 1906-1908 etj.¹⁸ Gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare shtypi luajti rol të rëndësishëm në informimin e përgjithshëm të popullit shqiptar dhe më gjerë. Shtypi shqiptar ishte organi më i mirë për t'i plasuar idetë iluministe në mbarë trevat shqiptare. Përmes shtypit u informua popullsia shqiptare për programet e hartuara, për luftën çlirimtare, për lejimin e gjuhës amtare etj.¹⁹ Ideologët e përdoren shtypin edhe për thirrje, tubime, protesta etj., që lidhën me çështjen kombëtare. Ishte element shumë i përshtatshëm dhe i domosdoshëm për të qarë përpara luftën çlirimtare dhe të drejtat e

¹⁶ Zija Xholi, *Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare*, “8 Nëntori”, Tiranë, 1987, f. 26.

¹⁷ Zihni Haskaj, *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, (Përmbledhje artikujsh nga shtypi) Vëllimi I (1879-1908), “Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë”, Tiranë, 1971, f. 8.

¹⁸ Masar Stavileci, *Idetë e Iluminizmit frëng...*, f. 319.

¹⁹ Zihni Haskaj, *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare...*, f. 9.

shqiptarëve. Jehona e shtypit shqiptar morri përmasa mbarëkombëtare gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Themelimi i shoqërive dhe klubeve shqiptare, veçanërisht në kolonitë në mërgim është një element tjetër i përpjekjeve shtesë e ideologëve për pavarësinë e Shqipërisë.²⁰ Shoqëritë kulturore shqiptare në emigrim përmes shkresave dhe thirrjeve të tyre drejtuar sulltanit dhe vendeve tjera evropiane kërkon lirinë e vendit të tyre, lejimin e gjuhës shqipe, hapjen e shkollave shqipe, përhapjen e shtypit në trevat shqiptare nën sundimin osman, të lejohet shpërndarja e shtypit që botohet jashtë atdheut të tyre etj. Po ashtu u bëhej më dije përmes shtypit që shqiptarët nuk do rrinë përgjithmonë duarkryq dhe do i marrin armët në duar për të luftuar për të drejtat e tyre.²¹ Krijimi i shoqërive dhe klubeve në mërgim luajti rol shumë të rëndësishëm në përhapjen e ideve iluministe te shqiptarët.

Përfaqësuesit më të shquar të iluminizmit shqiptar si: Naum Veqilharxhi, Pashko Vasa, Naim Frashëri, Sami Frashëri etj., ishin frymëzuar nga veprat e Volterit, Rusoit, Didëros etj., që fryma e tyre iluministe në forma të ndryshme ta përhapin edhe në trevat shqiptare gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Naum Veqilharxhi,²² ishte ndër ideologë e parë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që me tërë veprimtarinë e tij kulturore dhe politike u vu në shërbim të lëvizjes kombëtare për çlirim e vendit. Që në rinin e tij u largua nga Shqipëria e Jugut, ku pjesën më të madhe të jetës e kaloi duke punuar në Rumani, dhe e zhvilloi gjithë veprimtarinë e tij në frymën iluministe. Gjatë qëndrimit të tij në Rumani, shpërtheu revolucionin rumun në vitin 1821, ku kërkesat dhe idetë e revolucionit rumun u bënë udhërrëfyes që Naumi të punonte edhe më shumë për atdheun e tij.²³ Me veprimtarinë dhe krijimtarinë kulturore, Naum Veqilharxhit dërgonte edhe mesazhe politike, sepse politikën e shihte si mjet më të afër për t'ia arritur

²⁰ Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Katalogu sistematik i dokumenteve (1832-1912), Politika, përgatitur nga Nevila Hoxha, Tiranë 982, f. 2.

²¹ *AQSH*, Fondi. 39, Dosja 1, f. 4.

²² Naum Veqilharxhi, u lind më 1797 në fshatin Vithkuqi në rrethin e Korçës. Ai ishte ndër figurat më të njohura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare të shek. XIX. Naumi për arsye të veprimtarisë për çështjen kombëtare ishte i përndjekur nga pushtuesit e huaj. U detyrua të largohej nga vendi përkohësisht për të emigruar në Rumani. Si student gjatë asaj kohe mori pjesë në revoltat-revolucionin e Vllahisë e Moldavisë. Në Rumani pati rastin të takohet edhe më bashkëvendës të cilët ishin larguar për motive të njëjta politike.

²³ Masar Rizvanolli, *Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare...*, f. 173.

qëllimit për çlirimin e vendit. Naum Veqilharxhi në qarkoren e tij dërguar bashkatdhetarëve në Shqipëri, analizon gjendjen tejet të rëndë nëpër të cilën kalonte Shqipëria, dhe rrugën më të mirë që duhet ndjekur që përmes ideve iluministe të ndryshojnë gjendjen e krijuar me shekuj në vend.²⁴ Naumi Veqilharxhi mendonte dhe e theksonte shpesh së një popull autokton i edukuar dhe i arsimuar nuk mund të jetojë përherë i shtypur dhe i sunduar. Përmes veprimeve kulturore dhe politike, Naumi u vu kundër synimeve greke dhe osmane, të cilët bënin përpjekje maksimale për shtypjen e ndjenjës kombëtare shqiptare, përmes përdorimit të gjuhës greke dhe të elementëve fetarë që ekzistonin në Shqipëri.²⁵ Idetë iluministe të Naumit bënin jehonë të madhe në mesin e shqiptarëve gjatë asaj kohe kur ideologjitë e kohës bënin përpjekje maksimale për të ruajtur dogmat fetare.

Rendësi të veçantë Naumi i kushtoi edhe mendimit pedagogjik shqiptar në gjysmën e shek. XIX, që ishte shumë më i avancuar nga mendimet pedagogjike të shek. XVIII. Pedagogjia shqiptare në Rilindjen Kombëtare Shqiptare luajti rol shumë të madh në përpjekjet e popullit shqiptar për liri dhe barazi. Naum Veqilharxhi ishte adhurues dhe përkrahës i madh i shkollës laike.²⁶ Punonte fuqishëm dhe bënte thirrje të arsimohen të gjitha shtresat e popullit pa dallime klasore, sepse deri në atë kohë shkolloheshin vetëm shtresat e pasura që kishin mundësi materiale. Naum Veqilharxhi në vitin 1844 në Rumani e botoi “Evetarin” e cila ishte edhe abetarja e parë e gjuhës shqipe. Abetarja kishte rëndësi shumë të madhe për arsimimin e shqiptarëve, dhe përhapja e saj në Shqipëri ishte shumë e vështirë. Pas shumë përpjekjeve arriti të shpërndahet në pjesët jugore të Shqipërisë, si në: Korçë, Përmet, Gjirokastrë, Berat etj.²⁷ Në vitin 1845 botoi abetaren e dytë “Fari i Ri Evetar Shqip për Djelm Nismëtorë”.²⁸ Me këtë i plotësoi mungesat që nuk i përmbushi abetarja e parë, ku bëri thirrje që të shpërndahet në gjithë Shqipërinë që nga Manastiri, Korça, Bythkuqi, Kolonja, Përmet, Berat, Vlorë, Çamëri,

²⁴ AQSH, Fondi.39, Dosja 1, f. 4.

²⁵ Myslim Islami, *Naumi Veqilharxhi*, “Rilindja”, Prishtinë, 1978, f. 8.

²⁶ Myslim Islami, *Naumi Veqilharxhi*, “8 Nëntori”, Tiranë, 1977, f. 15-16.

²⁷ *Historia e Popullit Shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet '30 të shek. XIX-1912*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë., “Botime Toena”, Tiranë, 2002, f. 99.

²⁸ AQSH, Fondi. 39, Dosja 3, f. 55; Naum P. Veqilharxhi, *Fari i Ri Evetar Shqip për Djelm Nismëtorë*, Mot i dytë, 1845, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1984.

Himarë, Gjirokastrë, Zagora, Tepelenë, Elbasan dhe në gjithë Gegërinë.²⁹ Naumi ishte ndër të parët që e kuptoi rëndësinë e gjuhës kombëtare për lirinë e vendit, ku përmes shkrimeve dhe abetares u mundua të realizonte qëllimet.

Gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare arsimit në gjuhë shqipe ishte gjëja më e çmuar dhe më e vështirë për zhvillimin e mirëfilltë të saj. Zhvillimi i arsimit, sipas Naum Veqilharxhit, i formonte njerëz të aftë për t'i qar përpara proceset kulturore, ekonomin, politike etj. Ngecja e vazhdueshme në hapjen e shkollave shqipe sipas Naumit, dërgonte drejt asimilimit dhe zhdukjes së kombit shqiptar. Shqiptarët vetëm të arsimuar në frymën e ideve iluministe dhe pa dallime fetare mund të shkonin përpara për t'ia arritur qëllimit të tyre nga sunduesit osmanë.³⁰

Naum Veqilharxhi me vizionin e tij e kundërshtonte hapjen e shkollave të huaja në Shqipëri, sepse ato i shikonte të rrezikshme dhe përçarëse për popullin shqiptar. Përmes letrës "Enciklike" u bënte thirrje prindërve që mos t'i dërgojnë fëmijët jashtë vendit për t'i shkolluar përpara së fëmijët të mësojnë gjuhën e tyre amtare. Ideja ishte se shkollat e hapura nga Greqia më shumë do i shërbenin interesave greke sesa interesave shqiptare. Mësimdhënësit e shkollave të huaja nuk jepnin mësimin e drejtë për historinë dhe kulturën shqiptare.³¹ Gjatë asaj kohë edhe përmes shkollimit në vendet si Perandoria Osmane, Greqia etj., bënin përpjekje që ata pak nxënës që kishin mundësi të shkolloheshin në një formë apo tjetrën i kthenin për vete, duke përqafuar ideologjitë e tyre fetare apo politike. Naumi mendonte të kalohej nga interesat e ngushta personale, sepse ato do i sillnin shumë dëme vendit.

Naum Veqilharxhi në letrën dërguar nipit të tij Calit, shprehu mendimin në frymën iluministe se kombi shqiptar tanimë ishte i formuar dhe bëri thirrje që të gjithë atdhetarët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit të ndihmojnë zhvillimin dhe fuqizimin e tij.³² Naum Veqilharxhi bënte thirrje për t'i kontribuar çështjes shqiptare e cila kishte nevojë për kontributin e tij, për të forcuar edhe më shumë idetë e iluministëve shqiptarë, të hiqte dorë nga frymëzimet antishqiptare, dhe t'i qasej punës për krijimin dhe

²⁹ Naum P. Veqilharxhi, *Fari i Ri Evetar Shqip për Djelm Nismëtorë*, Mot i dytë, 1845..., f. 1.

³⁰ Koli Xoxi, *Revolucioni borgjez francez 1789-1794, dhe jehona e tij në mjedisin shqiptar*, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1980, f. 113.

³¹ Islam, *Naum Veqilharxhi ...*, f. 112.

³² *AQSH*, Fondi.39, Dosja 2; Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Rilindja Kombëtare Shqiptare, Vëllimi I (Katalog i materialeve dokumentare të fondeve personale), Tiranë, 1976, f. 26.

zhvillimin e kulturës shqiptare. Të gjitha kombet përpara nesh kanë filluar nismën e tyre dhe pastaj janë bërë të fuqishme, prandaj edhe ne duhet të nisemi në këtë rrugë të gjatë për të shkuar drejt realizimit të qëllimeve tona. Kombi shqiptar, i krijuar si të tjerët, i vendosur në një vend të caktuar në dheun e vet, që kishte gjuhën, zakonet dhe kulturë të veçantë, duhej të çlirohej nga ideologjitë e krijuara dhe të shkonte drejt formimit të shtetit të pavarur shqiptar.³³ Naum Veqilharxhi i vuri kontaktet edhe me koloninë e arbëresheve të Italisë në krye me Jeronim De Radën. Te arbëreshët shkruhej për suksesin dhe jehonën që kishte bërë “Evetari” i Naumit. Përmes kontakteve që u krijuan me arbëreshet e Italisë, Naumi u bëri thirrje të kontribuonin për zhvillimin e atdheut të të parëve të tyre, Shqipërinë.³⁴ Ideali iluminist i Naum Veqilharxhi ishte për zhvillimin e arsimit në gjuhën kombëtare, e cila ishte e vetmja zgjidhje dhe rrugë për ndryshimin e gjendjes shoqërore dhe politike në vend. Idetë e tija u përqaftuan dhe u përkrahën edhe nga ideologët e brezit të ri të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Pashko Vasa,³⁵ ishte njëri ndër ideologët më të njohur të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Veprimtarinë e tij politike dhe kulturore e zhvilloi në kohën kur populli shqiptar luftonte për çlirimin dhe formimin e kombit shqiptar. Më veprimtarinë e tij kulturore u mundua t’i tregojë edhe vendeve perëndimore se shqiptarët kanë historinë e tyre, traditën, gjuhën etj.³⁶ Pashko Vasa me idetë e tij iluministe duke bashkëpunuar edhe me ideologët tjerë të rilindjes, filluan veprimtarinë e tyre politike dhe kulturore për botimin e veprave, madje qoftë edhe në gjuhët e huaj, për t’u treguar vendeve perëndimore për kulturën dhe të kaluarën e shqiptarëve që vazhdonin të vuanin nga sundimi osman.

Pashko Vasa, sikur iluministët tjerë edhe ky e vinte në pah mungesën e tolerancës fetare dhe shtypjen e shqiptarëve nga Perandoria Osmane. Populli shqiptar që flet gjuhën e të parëve të tyre, ruan dhe

³³ *Po aty*.

³⁴ Ismet Dermaku, *Paraqitja e Naum Veqilharxhit dhe rëndësia e veprimtarisë së tij iluministe e patriotike (1797-1854), Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe në Bullgari*, Prishtinë, 1986, f. 67.

³⁵ Pashko Vasa, u lind më 17 shtator 1825 në Shkodër, paraardhësit e fisit të tij ishim me orgjinë nga Mirdita. Pasi u arsimua në vendlindje filloi punën si sekretar i konsullatës britanike në Shkodër nga viti 1842-1847, që iu mundësua të mësojë dijen edhe gjuhët e huaja, si: italishten, frëngjishten, greqishten, turqishten etj. Veprimtar i dalluar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

³⁶ Vaso Pashko, *Bardha e Temalit*, Prishtinë, “Rilindja”, 1990, f. 10.

kultivon traditat kulturore që padrejtësisht Perandoria Osmane e ndante dhe e identifikonte popullin shqiptar në tri besime të ndryshme fetare, si: mysliman, ortodoks dhe katolik. Kjo ndarje ishte e dhunshme dhe e papranueshme për shqiptarët gjatë asaj kohe, që e dëmtoi në masë të madhe të ardhmen e popullit shqiptar. Ndarjet e tilla nga pushtuesit osmanë u bënë me vetëtijë të plotë për asimilimin e shqiptarëve.

Populli shqiptar që flet një gjuhë me traditat kulturore të njëjta, ishte i ndarë në tri besime fetare: mysliman, ortodoks dhe katolik. Kjo ndarje e ka dëmtuar në masë të madhe të ardhmen e shqiptarëve.³⁷ Pashko Vasa me idetë iluministe punoi fuqishëm për zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare. Ai ishte ithtar i madh i shkollës shqipe, sepse arsimimi i të rinjve do të ishte rruga më e mirë për afirmimin kombëtar. Arsimimi i përgjithshëm i shqiptarëve ishte rruga e drejtë dhe më e mirë për t'i arritur synimet tona kombëtare.³⁸ Pashko Vasa gjatë kohës kur ishte anëtar i Komitetit Kombëtar të Stambollit (Kostandinopojës), ofroi poemën e tij patriotike “E mjera Shqipëri”. Përveç kësaj, vepër tjetër e ideologut shqiptar Pashko Vasa që u konsiderua si një nga shkrimet më të shquara të letërsisë politike të këtyre viteve, ishte edhe vepra e titulluar: “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”, botuar më 1879 në gjuhën shqipe, frëngjisht edhe në gjuhë të tjera.³⁹ Pashko Vasa përmes veprave u mundua të tërhiqte vëmendjen dhe të përçojë mesazh të fortë opinionit ndërkombëtar mbi padrejtësitë dhe shtypjen e vazhdueshme që Perandoria Osmane u bënte popullit shqiptar.

Naim Frashër,⁴⁰ njohuritë e para i mori në Gjinnazin “Zosimea” të cilat ia hapen horizontin për të ardhmen e tij intelektuale. Padyshim se Gjinnazi “Zosimea” kishte nivel shumë të lartë të arsimimit gjatë asaj kohe. Naimi pati fatin të mësojë letërsinë klasike dhe moderne të kohës. Naimi mësoi për pikëpamjet e iluminizmin frëng për të cilin ruajti një

³⁷ Christian Gut, *Pashko Vasa*, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Botime të veçanta LXXXIX, Seksioni i Gjuhës dhe Letërsisë, Libri 38, Prishtinë, 2008, f. 132.

³⁸ Masar Rizvanolli, *Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare...*, f. 206.

³⁹ Arben Puto, Stefanaqo Pollo, *Histoire De L'Albania des origins à nos jours*, Roanne France, Harvath, 1974, f. 152-153.

⁴⁰ Naim Frashëri u lind në Frashër të Përmetit. Ishte njëri ndër përfaqësuesit më të shquar të Rilindjes Kombëtare gjatë shek. XIX dhe hartues tekstesh në gjuhën shqipe. Gjatë shkollimit dhe arsimimit mësoi shumë gjuhë të huaja të kohës, si: arabishten, persishten, turqishten, greqishten dhe frëngjishten. Naimi përmes gjuhëve të huaja arriti të mësojë për zhvillimin e ideve iluministe në Evropë dhe më gjerë.

admirim të madh.⁴¹ Ai i admironte shumë pikëpamjet iluministe të Volterit, Rusos etj. Vendosija e kontakteve të para me vendet perëndimore dhe veçanërisht me Francën, e bëri atë që të mësojë gjuhën frënge dhe të njohë më mirë zhvillimin dhe frymën iluministe. I pasionuar nga idetë iluministe filloi të botojë shkrime në revistën “Drita” dhe “Dituria” të Stambollit, ku si qëllim kishte zhvillimin dhe botëkuptimin e ri në zhvillimin e kulturës dhe gjuhës shqipe.⁴² Naimi ishte ithtar i pikëpamjet iluministe të filozofëve francezë, se të menduarit e drejtë është aftësia bazë për zhvillimin dhe përvetësimin e njohurive të reja rreth zhvillimeve kulturore. Vetëm me bindjen e të menduarit njeriu mund t’i arrijë qëllimet që ai dëshiron.⁴³ Naimi përmes zhvillimit të kulturës shqiptare e shfrytëzoi për të menduar edhe politikisht për formimin e shtetit shqiptar me tipare demokratike.

Naimi përmes pikëpamjeve iluministe i kundërshtonte dogmat fetare, sepse religjionet në Shqipëri ishin të ndikuara nga sunduesit e huaj, të cilët e përdornin elementin fetar gjatë gjithë shekujve për interesat e tyre politike kundër shqiptarëve. Naimi së bashku me ideologët tjerë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare e vlerësuan si sfidë goxha të madhe tejkalimin e elementit fetar, sepse religjioni ishte pjesë shumë e ndjeshme e popullit. Religjioni në mesin e shqiptarëve u shtrua si problem që duhej zgjidhur njëherë e përgjithmonë. Naimi mendonte se shqiptarët ishin një kombësi kompakte, ku feja duhet të trajtohet dhe të zbatohet vetëm në suaza të besimit fetar. Përfaqësuesit e iluminizmit shqiptar me punën e tyre të palodhshme arritën të trajtonin çështjen shqiptare duke mos e ngatërruar me religjionin që ishte një arritje e madhe drejt formimit të shtetit shqiptar.

Naimi mendonte se zhvillimi i kulturës, gjuhës dhe shkollës shqipe do t’i hapte rrugë arsimimit në masë të madhe shoqërisë shqiptare, sepse vetëm të arsimuar dhe të emancipuar shqiptarët mund të zhvillonin të ardhmen e tyre kulturore, politike, ekonomike etj. Naimi dha kontribut shumë të madh për edukimin, arsimimin dhe hapjen e shkollave shqipe. Karakteristikë e pikëpamjeve të iluministëve shqiptarë ishte që përmes platformës politike dhe luftës çlirimtare të fitonin lirinë e tyre.⁴⁴ Naim Frashëri dhe ideologët tjerë me punën e tyre e ngjallën dhe e kthyen dashurinë për atdheun e tyre, sepse një komb për shekuj me radhë nuk

⁴¹ Grup autorësh, *Historia e Letërsisë Shqipe I-II*, “Rilindja”, Prishtinë, 1989, f. 65.

⁴² Masar Rizvanolli, *Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare...*, f. 213.

⁴³ Rexhep Qosja, *Porosia e Madhe*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 216.

⁴⁴ Masar Rizvanolli, *Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare...*, f. 221.

mund të jetojë i shtypur. Naimi filozofinë iluministe tek shqiptarët e konceptoi nga nevojat kulturore dhe politike të kohës, ku parashihte si domosdoshmeri zhvillimin e shkrimit në gjuhën shqipe dhe hapjen e shkollave kombëtare. Ai mendonte se përmes ditorisë, kulturës, arsimit dhe edukatës shqiptarët mund ta fitojnë lirinë dhe pavarësinë e vendit. Naimi arsimimin e shqiptarëve në masë të madhe e nënkuptonte si zhvillim i mirëqenies shoqërore dhe çlirim i popullit shqiptar.

Sami Frashëri,⁴⁵ padyshim ishte ndër iluministët më të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Shkollimi në Gjinnazin “Zosimea”, ia mundësoi Samiut të njihet më veprat e iluministëve më të shquar të Evropës. Mori njohuri të rëndësishme kulturore dhe politike që u bënë udhërrëfyese për veprimtarinë e tij në interes të çështjes kombëtare.⁴⁶ Samiu me krijimtarinë e tij kulturore, filozofike, politike dhe shkencore, u bë ndër ideologët më të njohur jo vetëm në trevat shqiptare por edhe më gjerë. Pikëpamjet iluministe të Samiut u bënë pjesë të pandashme e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Përmes ideve politike i dha një dorë të fuqishme edhe programit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Samiu pasi u largua në drejtim të Stambollit u njohë më mirë për rrjedhat politike dhe fetare brenda Perandorisë Osmane. Ishte ithtar i madh i mendimit të lirë. Me veprimtarinë e tij kulturore arriti të sensibilizonte edhe më tepër çështjen kombëtare. Përmes pikëpamjeve iluministe Samiu u mundua t’u tregoi popujve të shtypur nga osmanët, rrugën që duhej ndjekur drejt lirisë. Mundësia më e mirë për të arritur qëllimet e dëshiruara ishte botimi dhe hartimi i librave shkollorë.

“Sikur iluministët francezë të shek. XVIII, edhe Sami Frashëri i jep lirisë kuptim shumë më të gjerë. Për të nuk mund të jetë i lirë edhe ai popull që mban të tjerët në robëri. I lirë është ai që nuk është në robëri dhe nuk i robëron të tjerët. Mendimi është i ngjashëm me mendimin e Volterit, i cili thoshte të jesh i lirë ajo është jeta e vërtetë, jeta natyrore e njeriut, çdo jetë tjetër është një dredhi, një komedi e keqe, në të cilën njeri lozë rolin e zotërisë, tjetri të robitë”.⁴⁷ Samiu nuk u pajtua me politikën e

⁴⁵ Sami Frashër u lind në Frashër të Përmetit. Mësimet e para i mori në vendlindje. Së bashku më vëllain e tij Naimin vijuan shkollimin në Gjinnazin “Zosimea”, që ishte ndër shkollat më të mira të kohës. Gjatë formimit të tij si intelektual pati rastin ta njihë më mirë filozofinë perëndimore, greqishten, italishten, frëngjishten dhe turqishten. Samiu ishte njëri ndër ideologët më të shquar të Rilindjes Kombëtare, i cili i dha shumë kulturës dhe formimit të shtetit shqiptar.

⁴⁶ AQSH, Fondi. 51, Dosja 31, f. 1; Ndrichim Kulla, *Antologji e mendimit shqiptar, 1870-1945*, “Plejad”, Tiranë, 2003, f. 62.

⁴⁷ Veli Veliu, *Ndikime letrare frënge-shqiptare...*, f. 90.

osmanëve që me shekuj e sunduan Shqipërin, duke u mohuar çdo gjë që lidhej me identitetin kombëtar të shqiptarëve. Në mënyra të ndryshme përmes shtypit, thirrjeve, botimeve, luftoi për lirinë që u kishte dhuruara natyra e në fakt që u mohojë nga sundimi osman.

Shtypi ishte njëra ndër format me të përshtatshme për të qar përpara programin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Nëpërmjet shtypit u informua pjesa më e madhe e shqiptarëve. Samiu në gazetën «Drita dhe Dituria», shpali dhe përhap idetë iluministe si ithtar i lirisë, diturisë dhe barazisë së qytetërimit. Samiu mendonte që përmes arsimit njeriu edukohet dhe ngrihet në nivelet më të larta si qenie njerëzore. Për realizimin e qëllimeve të tilla duhej hapja e shkollave dhe hartimi i librave.⁴⁸ Pikëpamjet iluministe të Samiut për qytetërimin dhe zhvillimin e kombit shqiptar drejt të ardhmes ishte dituria dhe arsimimi. Për të ecur përpara drejt emancipimit dhe qytetërimit të shoqërisë sonë, njeriu duhej të mendojë dhe të veprojë për gjërat që mendon se janë të arsyeshme dhe të behët faktor për të ndryshuar për të mirë.⁴⁹ Pikëpamjet iluministe të Samit për arsimim në gjuhën shqipe e ngritën në nivelin më të lartë si intelektual dhe vizionar, duke u krahasuar me iluministët më të njohur të kohës. Samiu përmes arsimimit bëri thirrje për bashkimin e popullit shqiptar në luftë për lirinë dhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve. Asnjë popull në Ballkan nuk ishte i shtypur dhe i diskriminuar nga çdo e drejtë elementare se sa populli shqiptar. Liria është gjëja më e shenjtë që njeriut i ka dhuruara natyra dhe askush nuk ka të drejtë të shtyp lirinë e tjetrit.

Samiu përmes pikëpamjeve iluministe u mundua t'u shërbente të gjithë popujve të shtypur të Ballkanit dhe më gjerë, për të fituar lirinë e tyre nga sunduesit osmanë. Sami Frashëri ishte autor i një numri fjalorësh, si: frëngjisht–turqisht (Kamus i fransevi, 1882), turqisht–frëngjisht (Kamus i fransevi, 1885), arabisht–turqisht (Kanus i arab). Vepra që kishte vlera të larta u shkrua në gjuhë osmane e cila ishte enciklopedia e tij «Kanus-ul alam» në gjashtë vëllime. Në këtë vepër Samiu e trajtoi në mënyrë të veçantë çështjen shqiptare.⁵⁰ Përmes enciklopedisë, Samiu u mundua t'i shpaloste idetë iluministe për lirinë dhe emancipimin e popujve që vazhdonin të vuanin sundimin e rëndë osman. Ashtu «*sikur Enciklopedia e Didëros edhe ajo e Samiut, dilte në dritë në një kohë kur shoqëria osmane njëlloj si shoqëria franceze e atëhershme ishte në një krizë të rëndë e cila*

⁴⁸ Zija Xholi, *Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare*, «8 Nëntori», Tiranë, 1987, f. 320.

⁴⁹ Sami Frashëri, *Qytetërimi Islam*, «Logos-A», Shkup, 2002, f. 14.

⁵⁰ Ndrëçim Kulla, *Antologji e Mendimit Shqiptar, 1870-1945...*, f. 63.

*mund të zgjidhej vetëm me shkatërrimin e rendit feudal. Si edhe Didëroi, edhe Samiu me Enciklopedinë synonte ta armatoste rininë e mësuar përparimtare më një botëkuptim të ri dhe me dije për t'i përgatitur dhe për t'i frymëzuar për ndryshimet rrënjësore shoqërore-politike që i kërkonte koha”.*⁵¹ Enciklopedia e Samiut u bë në njëfarë mënyre si udhërrëfyes dhe thirrje e shqiptarëve për të punuar fuqishëm për të fituar lirinë e tyre të humbur gjatë shekujve.

Gjatë shek. XIX në krahasim më ideologët e tjerë, Samiu u ngrit në nivelet më të larta të vizionit të tij politik. Ai mendonte që për formimin e shtetit shqiptar platforma më e përshtatshme do ishte ajo republikane. Këtë mendim e synonin edhe iluministët francezë. Samiu botoi veprën e madhe “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”, ku brenda veprës u trajtuan shumë çështje kulturore dhe politike rreth të kaluarës dhe të ardhmes së Shqipërisë.⁵² Sami Frashëri e pa të nevojshme hartimin e programit ku parashikonte formimin e një shteti demokratik shqiptar. Me këto ide Samiu kërkonte zhvillimin dhe përhapjen e mësimit në popull, ku ishte për arsimin e detyrueshëm gjashtëvjeçar me frymën laike. Samiu mendonte se nuk mund të ketë Shqipëri pa gjuhën shqipe dhe pa shkolla në të cilat do të mësohej gjuha shqipe.⁵³

Pikëpamjet iluministe të Sami Frashërit, Naimit Frashërit, Naum Veqilharxhi, Pashko Vasës etj., u bënë udhërrëfyes për të ardhmen që shqiptarët të formonin një shtet laik që do të gjente përkrahje edhe nga vendet me të përparuar të Evropës Perëndimore. Kjo ishte moto edhe e iluministëve dhe filozofëve më njohur të Evropës. Mbi frymën e ideve të reja iluministe, shqiptarët mund të formonin dhe të zhvillonin shtetin e tyre kombëtar.

⁵¹ Veli Veliu, *Ndikime letrare frënge-shqiptare...*, f. 119.

⁵² Ali Dida, “Ndikimi i ideve politike e shoqërore të iluminizmit frëng në Rilindjen Kombëtare Shqiptare...”, f. 83.

⁵³ Sami Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet*, Prishtinë, 2007, f. 94.

Luan TETAJ

SUMMARY

**ENLIGHTENMENT VIEWS AND ALBANIANS DURING THE
ALBANIAN NATIONAL RENAISSANCE**

It was difficult or almost impossible for enlightenment ideas to develop within a particular place. Each country made a valuable contribution toward embracing and integrating into the new enlightenment views, depending on their economic, cultural, political, etc. development. As a core principle of enlightenment ideas was the strengthening of reason, development of education, science and culture. Enlightenment views spread in Eastern and Southeastern Europe as well. The enlightenment ideas were influenced and embraced by the most prominent Albanian ideologues during the Albanian National Renaissance in the XIX century. Enlightenment views had deeply penetrated the Albanian National Renaissance during the XIX century. Ideologues of our renaissance became great supporters of French, English, etc. enlightenment ideas. Albanians that were conquered by the Ottoman Empire for centuries, were denied freedom, education in their native language and every other basic rights to life. Most prominent representatives of the Albanian Enlightenment like Naum Veqilharxhi, Pashko Vasa, Naim Frashëri and Sami Frashëri embraced the enlightenment ideas firmly and worked toward the education of the Albanian people since education was the only way to free themselves from the Ottoman rulers politically. Enlightenment ideas promoted the liberation movements that demanded freedom of the country from the Ottoman rulers. During this time, the mind of knowledge not only played a significant part in Albanian society, it also played the part of a rifle as well because it was the only way to fight for the freedom of the country. Development of the Albanian political thought during the Albanian National Renaissance was reflected in the literary development in the enlightenment and patriotic spirit that galvanized the development of secular education in the national language.